



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 28/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED], si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përmbaruesi privat, [REDACTED] dhe përfaqësuesit të autorizuar të tij [REDACTED] dhe pas seancës këshillimore, me datën 02.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-28/2021, datë 23.09.2021 si dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të pala ankuese [REDACTED] me seli në Shtime, [REDACTED] dt 21.09.2021, si të pabazuara.

A R S Y E T I M

Me datën 21.09.2021, pala ankuese [REDACTED] me seli në Shtime, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar Av [REDACTED] ka paraqitur një ankesë në Ministrinë e Drejtësisë-Departamentin për Profesione të Lira, Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. [REDACTED] për shkelje disiplinore. Pala ankuese thekson që me dt 03.08.2021 ka pranuar një vërejtje nga përmbaruesi privat [REDACTED], i cili ka kërkuar pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore në shumën prej 371.17 Euro, duke obliguar palën debitore [REDACTED] që të paguajë edhe shpenzimet e efikasitetit përkundër se nuk ka pasur të drejtë për realizimin e shpenzimeve të efikasitetit pasi që pala debitore pas pranimi të urdhrorit për përmbarim menjëherë ka përmbushur në tërësi borxhin. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat është dashur që të arkëtojë vetëm shumën për administrimin e lëndës dhe

shumën për veprimet përmbaruese. Duke arkëtuar edhe shpenzimet për efikasitet, përmbaruesi privat [REDACTED] ka vepruar në kundërshtim me nenin 367 par 1, nën par 1.1, 1.2 dhe 1.7 të LPP dhe në shkelje të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr 06/14 për Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve të Përmbaruesit Privat. Rrjedhimisht, pala ankuese kërkon që ndaj përmbaruesit privat [REDACTED] Komisioni Disiplinor të shqiptoj masë disiplinore-gjorbë dhe të obligojë të njëjtin t'ia kthej palës debitore shumë e arkëtuar në emër të shpenzimeve të efikasitetit.

Me datën 23.09.2021, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit private [REDACTED] si organ përmbarues, i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED], lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën P. nr 157/2021.

Përmbaruesi privat [REDACTED] në përgjigjen e tij me shkrim thekson se sipas propozimit të palës kreditore dt 28.04.2021, është lëshuar urdhri përmbarimor P. nr 157/21, i cili i është ekspeduar debitorit përmes postës. Pasi nga fletë kthesa rezultonte që *“pala është shpërngulur nga kjo adresë”*, përmbaruesi privat thekson se me dt 07.05.2021 ka ridërguar urdhrin përmbarimor në adresën e palës debitore, sipas të dhënave të siguruara nga regjistri i ARBK-së. Sipas përmbaruesit privat me dt 12.05.2021, është kthyer fletë kthesa se urdhëri përmbarimor është pranuar nga debitori. Pas tetë (8) ditësh nga pranimi i urdhrin, i njëjti ka marrë formën e prerë. Përmbaruesi privat thekson se pala debitore ka përmbyshur obligimin me dt 24.05.2021, rrjedhimisht pas afatit për përmbyshje vullnetare dhe për këtë arsye pala debitore është ngarkuar edhe me shpenzimet për efikasitet.

Me datën 02.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, përmbaruesi privat, [REDACTED] dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar [REDACTED]. Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu edhe përmbaruesi privat dhe përfaqësuesi i autorizuar i tij, kanë ngelur pranë përgjigjes së paraqitur me shkrim si dhe ka bërë eleborimin e saj.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat z. [REDACTED] nuk ka kryer shkelje disiplinore.


Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Komisioni gjen se pala debitore ka pranuar urdhrin përmbarimor me dt 12.05.2021, siç edhe evidentohet nga fletë kthesa e cila është administruar si provë materiale. Ndërsa, përmbyshja e detyrimit nga pala debitore, është realizuar me dt 24.05.2021, siç evidentohet nga fletë transaksioni i realizuar përmes bankës TEB Kosova. Bazuar në këtë gjendje të konstatuar faktike, Komisioni vjen në përfundim që pala debitore nuk ka realizuar përmbyshjen vullnetare brenda afatit prej (7) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin përmbarimor. Si rezultat, pala debitore obligohej për pagesën e shpenzimeve të efikasitetit dhe kjo

është në përputhje me nenin 367 par 1, nën par 1.1,1.2 dhe 1.7 të LPP dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr 06/14 për Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve të Përmbuesit Privat. Në fakt, duke njoftuar palën debitore përmes vërejtjes që të përmbush edhe shpenzimet e efikasitetit, përmbuesi privat është përmbajtur nga krijimi i shpenzime tjera përmes ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore. Në këtë mënyrë, përmbuesi ka vepruar drejtë për t'u siguruar që përmbarimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për palën debitore. Rrjedhimisht, Komisioni gjen se përmbuesi privat ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet e tij.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 28/2021, datë 02.11.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

